

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**
Bordi**VENDIM****Nr. 138, Datë 06.09.2017****MBI****FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AFRIMI K”
SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “THANZË” ME FUQI TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma “b” nuk është plotësuar. Gërmat “a” “c” “d” “f” dhe “g” plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “b” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; dhe 4.1.4), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me nenin 9, pika 2, gërma “b”, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin,

Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike“, neni 11, pika 1, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë nga HEC “Thanzë” me fuqi të instaluar 2 MW.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI